



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË,  
BASHKIA KONISPOL, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VËREN:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendore, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor me vendimin nr.146, datë 15.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për këshillin e bashkisë Konispol, kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ nuk rezulton të jetë bërë ankimi.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për Këshillin e Bashkisë Konispol për subjektet zgjedhore është si tabela nr.1 më poshtë.

(Tabela 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Perqindja
1	Bashkë Fitojmë	669	15,59 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	1706	39,76 %
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	85	1,98 %

Data: . . 2023 Nr:  
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Konispol për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

4	Partia Republikane Shqiptare	317	7,39 %
5	Partia Levizja e Legalitetit	269	6,27 %
6	Partia Demokracia Sociale	183	4,26 %
9	Partia Demokratike	427	9,95 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	635	14,80 %
	<b>Totali</b>	<b>4291</b>	<b>100 %</b>

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Konispol, në bazë të shkresës nr. 211/1 Prot., datë 27.02.2023, të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2 bashkëlidhur.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin si në tabelën nr. 3, më poshtë.

(Tabela 3)

Nr.	Heresi	Subjekti
1	1706	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	853	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	669	Bashkë Fitojmë
4	635	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
5	568	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	427	Partia Demokratike
7	426	Partia Socialiste e Shqipërisë
8	341	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	334	Bashkë Fitojmë
10	317	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
11	317	Partia Republikane Shqiptare
12	284	Partia Socialiste e Shqipërisë
13	269	Partia Levizja e Legalitetit
14	243	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	223	Bashkë Fitojmë

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve si në tabelën nr. 4, më poshtë.

(Tabela 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	3
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	7
3	Partia Republikane Shqiptare	1
4	Partia Levizja e Legalitetit	1
5	Partia Demokratike	1
6	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Konispol, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	3
Partia Socialiste e Shqipërisë	7
Partia Republikane Shqiptare	1
Partia Levizja e Legalitetit	1
Partia Demokratike	1
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	2

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Konispol, si më poshtë:

### **Bashkë Fitojmë**

1	Gjergji	Kozma	Mano
2	Elsa	Jorgji	Stefani
3	Erion	Safet	Ademi

### **Partia Socialiste e Shqipërisë**

1	Arianit	Ismail	Taka
2	Paola	Veiz	Ali
3	Proko	Dhonat	Kote
4	Salihe	Kanan	Frëngu
5	Edlir	Hekuran	Avdi
6	Majlinda	Mark	Doda
7	Qemal	Hekuran	Mulla

### **Partia Republikane Shqiptare**

1	Hamlet	Gazali	Muka
---	--------	--------	------

### **Partia Levizja e Legalitetit**

1	Enio	Përparim	Selmani
---	------	----------	---------

### **Partia Demokratike**

1	Marinela	Sulo	Papa
---	----------	------	------

### **Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet**

1	Sildi	Trashëgim	Koqini
2	Amarildo	Murat	Emini

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: . . 2023 Nr:  
Ora:



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë, Bashkia Konispol për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”